

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-35/11

Prishtinë,  
1 Shtator 2011

Në çështjen ligjore të

**L.B.**

*Ankuesi/Pasardhësi i paraqitësit të kërkesës*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit, Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, Gjyqtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/76/2010, (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA 23181), të datës 16 qershor 2010, pas seancës së mbajtur mbajtur me 1 Shtator 2011, muarr këtë

**AKTGJYKIM**

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e L.B.
- 2- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës KPCC/D/A/76/2010 i datës 16 qershor 2010, për sa i përket lëndës së regjistruar me Nr. KPA23181.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 50 (pësdhjetë) euro, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### **Përmbledhja e çështjeve faktike dhe juridike:**

Më 29 maj 2007 D.B. ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkonte vërtetimin e të drejtës pronësore, ri-posedimin dhe kompenzimin për shfrytëzimin e tokës-parcelës nr. 52, me kulturë të klasit të 4-të, e cila gjendet në vendin e ashtuquajtur “Belincë”, zona kadastrale e Dobërdol, nr. i fletës poseduese 46, me një sipërfaqe prej 0, 47, 12 ha. Ai ka theksuar se kjo paluajtshmëri i është uzurpuar nga personat e panjohur dhe këtë pronë e ka humbur për shkak të rrethanave të luftës në vitet 1998/99.

Për të mbështetur kërkesën e tij, ai i ka dorëzuar AKP-së fletën poseduese nr. 46 të Drejtorisë Komunale Gjeodeze të Komunës së Pejës, zona kadastrale e Dobërdol-it, që konstaton se parcela e kërkuar ishte e regjistruar nën emrin e tij.

Raporti i përpunimit të kërkesës për KKPK-në, i datës 5 Maj 2010 konstaton se në përputhshmëri me listën poseduese nr.46 e azhurnuar me datë 20 Tetor 2009, e lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, dhe Pronë e Komunës së Pejës, parcela kadastrale nr.52 ishte regjistruar në emër të paraqitësit të kërkesës D.B., por vetëm në 1/3 e pjesës ideale. Si rezultat i këtyre të dhënave të azhuruara AKP-ës i është dorëzuar aktgjykimi C.nr.629/95 i datës 6 Prill 1998 i lëshuar nga Gjykata Komunale në Pejë që i referohet aktgjykimit përfundimtar C.nr.813/80, të datës 27 Tetor 1980, gjithashtu i lëshuar nga Gjykata Komunale në Pejë, dhe që sipas zyrës kadastrale ka shërbyer si bazë ligjore për këtë regjistrim. Aktgjykimi me i fundit ka shërbyer si bazë për të drejtën e pronësisë të tre vëllezërve, D., S. dhe S.B. nga 1/3 e pjesës ideale për secilin prej tyre në palujtshmërinë, lista poseduese nr. 46 të zonës kadastrale Dobërdol, duke përfshirë edhe parcelen nr. 52.

Raporti i përpunimit të kërkesës evidenton faktin se publikimi i kërkesës së paraqitur ishte bërë me 4 Mars 2008 dhe se njoftimi ishte bërë duke vënë njoftimin në parcel me datë 5 Nëntor 2009. Asnjë palë përgjegjëse nuk ka mundur të identifikohet dhe se palujtshmëria nuk ishte në shfrytëzim. Mbrenda afatit kohor prej 30 ditësh nga dita e njoftimit asnjë palë përgjegjëse nuk është përgjegjur në kërkesë lidhur me palujtshmërinë objekt kontesti.

Raporti i përpunimit të kërkesës së AKP-ës potencon humbjen e posedimit me 12 Qershor 1999 duke si rezultat i i situatës së përgjithme në Kosovë dhe se e drejta në paraqitjen e kërkesës nuk ka mund të ushtrohet për shkak të situatës së përgjithshme në Kosovë, si rezultat i rrethanave të krijuara nga konflikti i armatosur midis 27 Shkurt 1998 dhe 20 Qershor 1999.

Në vendimin e KPCC/D/A/76/2010, i datës 16 Qershor 2010, KKPK-ja kishte vendosur se paraqitësi i kërkesës kishte dëshmuar të drejtën e tij të pronësisë për 1/3 e pronës së kërkuar dhe kishte të drejtë posedimi mbi këtë pronë, dhe se cilido person që kishte uzurpuar këtë pronë duhej ta lironte atë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e pranimit të vendimit. Komisioni gjithashtu ka refuzuar kërkesën e paraqitur për sa i përket kompenzimit për dëmin e pësuar për shkak të shfrytëzimit për faktin e mospasjes së juridiksionit për të vendosur në lidhje me këtë kërkesë.

Vendimi i KKPK-së është pranuar nga L.B. – djali i paraqitësit të kërkesës me 4 Shkurt 2011. Djali i paraqitësit të kërkesës ka ushtruar ankesë me 16 Shkurt 2011. Me ankesën e tij L.B. ka dorëzuar certifikatën e vdekjes, e lëshuar me 6 Dhjetor 2010 nga Komuna e Krlevës, Republika e Serbisë, e cila vërteton se babai i tij kishte vdekur me 30 Nëntor 2010 dhe dy fletët poseduese që veq ishin dorëzuar në KKPK. Ai kishte atakuar vendimin e KKPK-ës nga bazat e parapara në Nenin 12.3 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 e amendamentuar me Ligjin nr. 03/L-079 për Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën Private të Paluajtshme, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, konkretisht: për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, duke propozuar vërtetimin e të drejtës pronësore mbi të gjithë pronën e paluajtshme-objekt kontesti i kërkesës së paraqitur nga babai i tij. L.B. ka mohuar çdo ligjshmëri të ndërrimeve në operatin kadastral me qëllim të regjistrimit të së drejtës së pronësisë e kufizuar në 1/3 e pjesës ideale.

#### **Arsyetimi ligjor:**

#### **Legjitimiteti i ankuesit:**

Si çështje paraprake, Gjykata Supreme vëren se ankesa është ushtruar nga djali i paraqitësit të kërkesës, i cili nuk ka qenë palë në procedurën e shklës së parë. Sipas Nenit 76 të Ligjit nr. 03/L-006 Mbi Procedurën Kontestimore “ Gjykata duhet që në çdo fazë të procedurës, të përkujdeset në mënyrë ex officio nëse një person i paraqitur si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse ai ose ajo ka zotësi për të vepruar në procedurë...”

Ankuesi i ka ofruar Gjykatës Supreme certifikatën e vdekjes së babait të tij e cila ofron të dhëna se paraqitësi i kërkesës ka vdekur me 30 Nëntor 2010. Në përputhshmëri me Nenin 227 (a) dhe 280.1 të njejtut ligj të procedurës kontestimore, kur pala vdes, procedura ipso facto e pezulluar mund të rinisë nëse pasardhësi i pasurisë së trashëguar ndërmerr veprimet procedurale.

Në rastin konkret, me ankesën në emër të babait të tij të ndjerë, L. B. në mënyrë shprehimore ka treguar vullnetin e tij të vazhdoj me procedurën e nisur nga i ati i tij.

Edhe pse ai nuk i ka prezentuar Gjykatës Supreme ndonjë vendim mbi trashëgimin, Kapitulli 5 i Udhëzimit Administrativ 2007/5 i amendamentuar me Ligjin nr. 03/L-079 në lidhje me përfaqësimin prane KKPK-ës dhe Gjykatës Supreme i lejon paraqitësit të kërkesës që të përfaqësohet nga antari i familjes, ndër të tjera edhe nga fëmijër e tij/saj.

Për shkak të këtyre arsyeve të kombinuara, Gjykata Supreme i mbetet qëndrimit se L.B. ka zotësinë e të vepruarit si palë në këtë procedurë.

### **Konkludimet juridike në ankesë:**

Gjykata Supreme aktgjykimin ankimor e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e Nenit 13.3 (c) të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 të amendamentuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe në pajtueshmëri me vlerësimin e saj të pretendimeve të ankuesit ka gjetur se ankesa është e pabazuar.

Gjykatës Supreme, duke u pasur parasysh situatën faktike të këtij rasti gjen se vendimi i KPCC/D/A/76/2010, i datës 16 Qershor 2010 që merret me kërkesën nr. KPA23181 është bazuar në vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe se e drejta materiale është zbatuar drejtë. Në vendimin e tij Komisioni jep arsye të mjaftueshme dhe të ligjshme për vendimarrje në lidhje me këtë rast dhe si të tilla ato janë të pranueshme për këtë gjykatë. Vendimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të LPK-ës të cilat do të duhej ngritur ex officio nga kjo gjykatë sipas Nenit 194 të LPK-ës. Konstatimi i gjendjes faktike dhe arsyet ligjore të KKPK-ës sipas kësaj gjykate janë drejta dhe të ligjshme dhe ofrojnë argumente të mjaftueshme përgjatë vlerësimit të fakteve kontradiktore.

Sipas Nenit 20 të Ligjit Themelor të Mardhënjeve Pronësoreshme-Juridike, aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Pejë ka marrë aktgjykimin përfundimtar C.nr.813/80 me datë 27 Tetor 1980, duke evidentuar pjesët ideale të bashkëpronësisë të ngastrës kadastrale nr.52 të zonës kadastrale Dobërdol, si 1/3 e secilit, D., S. dhe S.B., të gjithë vëllezër. Ky aktgjykim nënkupton bazë ligjore e vlefshme për të fituar të drejtat pronësore të evidentuara në fletën poseduese nr. 46 të datës 4 Mars 2008 dhe 20 Tetor 2009 lëshuar nga Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Pejës themeluar nga Insitucionet e Përkohshme Vetqeverisëse të Kosovës. Sipas kësaj liste poseduese tre vëllezërit D., S. dhe S. janë të regjistruar si bashkëpronar në pjesët ideale. Për të mohuar këtë fakt ankuesi ka ofruar listën poseduese të datës 5 Mars 1996 dhe atë të datës 3 Prill 2008. Sidoqoftë, pretendimet e

tilla të pabazuara, të papranueshme, të pakuptueshme dhe kontradiktore nuk janë provuar, për shkak se është lëshuar nga ana e zyrës kadastrale e Republikës së Serbisë, e cila nuk është operuese në Kosovë prej kur UNMIK-u ka themeluar zyrën kadastrale. Siç shihet, zyra e Serbisë nuk është marrë në konsideratë ose sepse nuk është dhënë aktgjykim përfundimtar, i cili është bazë ligjore për regjistrimin e titullit juridik të poseduesve të palujtshëmrisë, ashtu siq edhe në mënyrë të drejtë është potencuar në listën poseduese nr. 46, datë 4 Mars 2008.

Nga faktet e sipërpërmendura, rezulton se situata faktike në këtë çështje ligjore është konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se vërtetësia e vendimit të KKKPK-ës nuk është vënë në pyetje nga asnjë dëshmi e vlefshme, për faktin se me ankesë nuk është sjellë asnjë argument ose fakt i paraqitur ndonjëher dhe që nuk ka qenë objekt shqyrtimi detal dhe i drejtë nga shkalla e parë; kështuqë, pretendimet e ankuesit se vëllezërit e ankuesit nuk kanë fituar të drejtën pronësore në mënyrë të ligshme ligjesisht janë të papranueshme. Këto pretendime kanë qenë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga KPPK-ja dhe si të tilla janë refuzuar drejtë.

Në vijueshmëri të kësaj edhe në se këto pretendime do të mund të provoheshin, ato nuk do të mund të ishin objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Gjykata Supreme konform nenit 3.1 e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e amandamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Në përputhshmëri me këto dispozita ligjore, Gjykata Supreme ka jurisdiksion në lëndët që kanë të bëjnë me të drejta pronësore të cilat nuk mund të ushtrohen si rezultat i rrethanave që në mënyrë direkte janë të lidhura ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhë ndërmjet 27 Shkurt 1998 deri 20 Qershor 1999.

#### **Shpenzimet e procedurës:**

Në përputhje me nenin 8.4 të Urdhërësës Administrative ( UD) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr: 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës që procedohet në Sekretariatit Ekzekutivë dhe Komisionit

Sido që të jetë, një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Gjykatës Supreme.

Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore ( Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UD Nr:2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Gjykatës Supreme.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës ( Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit ( Nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë, siç ceket në raportin vlerësues të Komunës së Pejës në kërkesen e Gjykatës Supreme është vlerësuar 5.000€ =25

Këto taksa gjyqësore i bart ankuesi në cilësinë e palës gjyqëdhënëse.

Në përputhje me Nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave nga tarifa në fjalë nga personi i cili ka venqëndrim ose vendbanim jashtë shtetit nuk mund të jetë me i vogël se 30 ditë dhe më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos se në rastin konkret, taksat nga tarifa gjyqësore nga ankuesi duhet të paguhet në afat prej 90 ditësh nga dita e dorëzimit atij të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë juridike**

Sipame nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i amandametuuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Nga të gjitha arsyet e sipërcekura dhe në bazë të dispozitave të nenit 13.3(c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i amandametuuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Nënshkruar nga: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Nënshkruar nga: Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it**

**Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Nënshkruar nga: Urs Nufer, Referent i EULEX-it**